

**KONTRATË SHITJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR TË  
SHOQËRISË "ALB SUN ENERGY" Sh.p.k**

Sot, më datën 29.12.2020 (dymijë e njëzetë), nënshkruhet kjo Kontratë Shitje Kuotash, mes palëve kontraktuese si më poshtë:

**PALA SHITËSE:**

- Z. Igli Meneci**, atësia Hil, lindur më 23.04.1989, në Qelez, Pukë dhe banues në Tiranë, Rr. "Kaktus", "Pallatet Elvis" 20, Fushë Mëzez, Kashar, pajisur me letërnjoftimin me Nr. 033751540 dhe Nr. Personal I90423095R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që zotëron 20% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "Alb Sun Energy" Sh.p.k, më poshtë referuar si "Shitësi".

**PALA BLERËSE:**

- Z. Nikolin Jaka**, atësia Frrok, lindur më 17.05.1972, në Mirditë dhe banues në Rrugën "Beqir Luga", Tiranë, pajisur me letërnjoftimin me Nr. 034406736 dhe Nr. Personal H20517177N, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që zotëron 80% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "Alb Sun Energy" Sh.p.k, më poshtë referuar si "Blerësi".

*Më poshtë referuar si veçmas "Pala" dhe së bashku "Palët".*

**Të dhëna paraprake:**

- Në Qendrën Kombëtare të Biznesit, është regjistruar si person juridik Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Alb Sun Energy" Sh.p.k., me NIPT L822080320.
- Me Vendimin Nr. 1, datë 29/12/2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, është vendosur të realizohet shitja e kuotave të kapitalit themeltar që Ortaku Z. Igli Meneci zotëron në Shoqërisë "Alb Sun Energy" Sh.p.k., tek pala blerëse, ortaku tjetër i shoqërisë, Z. Nikolin Jaka si më poshtë:
  - Z. Igli Meneci do t'i shesë Z. Nikolin Jaka 20% (njëzetë përqind) të kuotave të kapitalit themeltar që ai zotëron në Shoqërinë "Alb Sun Energy" Sh.p.k;



*Palët, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosën të nënshkruajnë këtë Kontratë të Shitjes së Kuotave të Kapitalit themeltar si vijon:*

**Neni 1 - Objekti i Kontratës:**

- Objekt i kësaj kontrate është shitja e 20% të kuotave të Kapitalit themeltar të Shoqërisë "Alb Sun Energy" Sh.p.k. nga Ortaku Z. Igli Meneci, tek ortaku tjetër Z. Nikolin Jaka në cilësinë e palës blerëse.

**Neni 2 - Përmbajtja e Kontratës**

- Shoqëria "Alb Sun Energy" Sh.p.k është person juridik shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 08.10.2018 me Nr. NIPT L822080320.



- 2.2 Shitësi Z. Igli Meneci, është një nga ortakët e shoqërisë "Alb Sun Energy" Sh.p.k, dhe pronar i 20 % të Kapitalit themeltar të kësaj shoqërie në vlerën 20 lekë (Njëzetë lekë).
- 2.3 Shitësi deklaron se me vullnetin e tij të plotë e të lirë i shet Blerësit, Z. Nikolin Jaka 20% të Kuotës së tij të Kapitalit, dhe Blerësi deklaron se është dakort me blerjen e tij.

### Neni 3 - Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 3.1 Palët kanë rënë dakort që çmimi i shitjes do të jetë **20 lekë (njëzetë lekë)**, çmim ky që përkon me vlerën e 20 % të kapitalit fillestar që kalon në pronësi të Blerësit.

### Neni 4 - Kalimi i pronësisë

- 4.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësi e humbet çdo të drejtë reale mbi këtë përqindje të kapitalit, ndërsa blerësi bëhet zotëruesi i ligjshëm i kësaj përqindjeje të kapitalit themeltar.
- 4.2 Blerësi, Z. Nikolin Jaka me blerjen e kësaj përqindjeje të kapitalit themeltar nga shitësi, bëhet ortak i vetëm i shoqërise dhe pronar në total i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë "Alb Sun Energy" Sh.p.k me NIPT L822080320, me seli në Rrugën "Beqir Luga", Pallati Nr. 3, Shkalla 1, Kati 0, Zona Kadastrale 8150, Tiranë, Shqipëri.

### Neni 5 - Interpretimi i kontratës në tërësi

- 5.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë Shitjeje.

### Neni 6 - Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

- 6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, janë objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.


### Neni 7 - Gjuha e kontratës

- 7.1 Kontrata përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secila dhe nënshkruhet rregullisht nga palët.

### PALËT

**PALA SHITËSE**

**IGLI MENECI**



**PALA BLERËSE**

**NIKOLIN JAKA**

